



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 1579 / prot.
2

Tiranë më 4.12.2018

VENDIM

Nr. 71, datë 04/12/2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1579 Prot., datë 23.10.2018, me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”, kundër Autoritetit Publik “Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës së datës 25.09.2018 ka kërkuar nga Autoriteti Publik t’i vihet në dispozicion dokumentacioni i disponueshëm në lidhje me:

- *Kopje të raporteve të grupit të punës në DSIK, mbi kontrollin e figurës të disa subjekteve të rivlerësimit, sipas listës bashkëlidhur kërkesës.*

Autoriteti Publik, me emailin datë 28.09.2018, ka kthyer përgjigje duke refuzuar dhënien e informacionit me argumentin se: “*Raportet për kontrollin e figurës të hartuara nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës në DSIK, janë dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si institucion vendimmarrës për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit*”.

Në po të njëjtën datë, kërkuesi ka përsëritur kërkesën me pretendimin se informacioni i kërkuar është deklasifikuar dhe për rrjedhojë duhet publikuar.

Më datë 12.10.2018, Autoriteti Publik ka kthyer përgjigje, duke refuzuar vënien në dispozicion të dokumentacionit me argumentin se: “*në pikën 2 gërma c) të nenit 17 të*

*ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", përcaktohet se: "E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:
c. mbarëvajtjen e hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor...".*

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, me shkresën nr.1579/1Prot., datë 31.10.2018, ka kërkuar nga autoriteti publik rivlerësimin e dhënies së informacionit brenda datës 05.11.2018.

Me shkresën nr. 3082 Prot., datë 02.11.2018, administruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1579/2 Prot., datë 09.11.2018, Autoriteti Publik ka rivlerësuar kërkesën, duke sqaruar se: *"Ankuesit do ti vihet në dispozicion kopje të raporteve të grupit të punës mbi kontrollin e figurës, vetëm për ata subjekte të rivlerësimit ndaj të cilëve Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka marrë vendim mbi konfirmimin ose jo në detyrë."*

Në ndjekje të procedurës, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" në të cilin citohet se *"Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... Kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve"*, me shkresën nr. 1579/3 Prot., datë 12.11.2018, Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e ankuesit nga njëra anë dhe përfaqësuesve të Autoritetit Publik nga ana tjetër.

Gjatë seancës, pala ankuese dhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në shqyrtimin e çështjes, gjejnë zbatim dispozitat e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Lidhur me argumentin e dhënë fillimisht nga Autoriteti Publik se: *"Raportet për kontrollin e figurës të hartuara nga Grupi i Punës për Kontrollin e Figurës në DSIK, janë dërguar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si institucion vendimmarrës për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit"* – Komisioneri vlerëson se neni 35 i Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", bazuar në Nenin DH të Aneksit të Kushtetutës përcakton dhe njeh shprehimisht dhe në mënyrë specifike rolin e Autoritetit Publik në kuadër të procesit të rivlerësimit të prokurorëve dhe gjyqtarëve.

Kjo është edhe fryma e paragrafit 40 dhe 43 të Vendimit nr. 02 datë 18.01.2017 (ku përmendet shprehimisht roli i DSIK-së në procesin e vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve

dhe prokurorëve) si dhe paragrafëve 37, 38 dhe 39 të Vendimit nr. 78 datë 12.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese, të cilat i veshin Autoritetit Publik si dhe autoriteteve të tjera ekzistuese të përfshira në procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rol ndihmës, në raport me institucionet e rivlerësimit të krijuara posaçërisht për këtë proces, si dhe i njohin këtyre institucioneve (pra KPK-së dhe KPA-së) të drejtën për të kryer hetime të mëtejshme në kuadër të vendimmarjes përfundimtare. Ky cilësim duhet parë në kontekstin e arsytimit të Gjykatës Kushtetuese të cilës i është dashur të shprehet për ruajtjen e ndarjes së pushteteve dhe pavarësinë e institucioneve të procesit të rivlerësimit, si dhe kontrollin e pjesëmarrjen e tyre në aktivitetin e organeve ekzistuese (ku bën pjesë dhe Autoriteti Publik) në kuadër të procesit të rivlerësimit, duke i konsideruar si dy procese të ndara administrative.

Sa i përket qëndrimit të mbajtur nga Autoriteti Publik në vijim, Komisioneri vë në dukje se Neni A i Aneksit të Kushtetutës së Rpublikës së Shqipërisë, përcakton shprehimisht se me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të Kushtetutës, veçanërisht atyre që lidhen ndër të tjera me të drejtën për respektimin e jetës private, kufizohen sipas nenit 17 të Kushtetutës.

Neni 17 i Kushtetutës parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara në Kushtetutë me ligj për një interes publik ose mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Nisur nga sa më sipër del qartë interesi publik që karakterizon procesin e rivlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Ky qëndrim mbështetet edhe nga Gjykata Kushtetuese në paragrafin 42, të Vendimit nr. 78, datë 12.12.2017 të saj, ku thuhet shprehimisht se: *"...ndërhyrja (duke iu referuar kufizimit të jetës private dhe familjare) në këtë rast justifikohet më interesin publik, që është ulja e nivelit të korrupsionit dhe rikthimi i besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pra lidhet me interesa të sigurisë kombëtare, sigurisë publike dhe mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të tjerëve. Për rrjedhojë, në rastin konkret ndërhyrja është bërë për një qëllim të ligjshëm, në këndvështrim të paragrafit të dytë të nenit 8 KEDNJ-së si dhe në respektim të nenit A të Aneksit të Kushtetutës që kufizon këtë të drejtë".*

Pika 7 e nenit 4 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", parashikon se e drejta e informimit, mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit.

Vlen për tu theksuar se, ky kufizim nuk gjen zbatim në rastin konkret pasi informacioni i kërkuar është informacion lidhur me një proces administrativ të përfunduar nga Autoriteti Publik. Gjithashtu, këto raporte (çka përbëjnë dhe objektin e kërkesës për informim të ankuesit) janë deklasifikuar nga Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvleftësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror" në DSIK si dhe botuar si bibliografi në Fletoren Zyrtare, Numri: 137, datë 25 shtator 2018.

Bazuar në nenin 39 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", grupi i punës i ngritur për këtë qëllim, në përfundim të procesit të kontrollit, harton një raport/dokument i cili përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 38 të ligjit të sipërpërmendur, të cilin ia paraqet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Nga fjalia e fundit e paragrafit 2 të nenit

39 të Ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" ku parashikohet se: "...informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër", rezulton se parimisht informacioni është publik dhe publikimi mund të kufizohet vetë nëse plotësohen kushtet e parashikuara më sipër.

Sa i përket kufizimeve të së drejtës për informim të parashikuara në nenin 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", theksojmë se në rastin specifik nuk zbatohen kufizimet e parashikuara në këtë nen për shkak të interesit publik që i është atribuar këtij procesi nga Kushtetuta dhe Vendimi nr. 78 datë 12.12.2017 i Gjykatës Kushtetuese (paragrafi 42), si dhe të parashikuara nga vetë ky nen si shkak për mozbatimin e kufizimeve të së drejtës për informim.

Në përmbyllje të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të Ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili parashikon se: "*Informacion publik*" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "*Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit*".

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i shqyrtuar dhe përmendur më sipër Zyra e Komisionerit vlerëson se, autoriteti publik duhet të ketë në vëmendje nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, në raport me personat e tjerë, jo subjekt i procesit të rivlerësimit.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e z. _____ ndaj Autoritetit Publik/Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

VENDOSA:

1. Pranimin e ankesës së z. me Nr. 1579 Prot., datë 23.10.2018, ndaj Autoritetit Publik, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, për vënien në dispozicion të informacionit:
 - Kopje të raporteve të grupit të punës në DSIK, mbi kontrollin e figurës të disa subjekteve të rivlerësimit, sipas listës bashkëlidhur kërkesës, brenda datës 14.12.2018.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani e këtij vendimi, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit"
4. Ky vendim u shpall sot me datë 04.12.2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

